



Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosovo

Agjencia e Kosovës për Akreditim
Agencija Kosova za Akreditaciju
Kosovo Accreditation Agency



Ref.: 1085/24 Datë: 30/05/2024

Në mbështetje të nenit 11 të Ligjit nr. 08/I-110 për Agjencinë e Kosovës për Akreditim (GZ.nr. 13 / 29 qershor 2023, Prishtinë, nenit 7 të Ligjit për Arsimin e Lartë në Republikën e Kosovës Nr. 04/L-037 (GZ, Nr.14/9 Shtator 2011), nenit 8 dhe 14 të Ligjit për Organizimin dhe Funksionimin e Administratën Shtetërore dhe të Agjencive të Pavarura të Republikës së Kosovës Nr.06/L-113 (GZ.Nr.07/01 mars 2019), Ligjit për Procedurën e Përgjithshëm Administrative Nr.05/L-031 (GZ.Nr.20/12 Qershor 2016), Udhëzimin Administrativ për Akreditimin e Institucioneve të Arsimit të Lartë në Republikën e Kosovës (Nr.15/2018, datë 28.09.2018), Rregulloren e Punës së Këshillit Shtetëror të Cilësisë, si dhe referuar procesverbalit të mbledhjes së 123-të, mbajtur me datë 20.05.2024, Këshilli Shtetëror i Cilësisë, mori:

V E N D I M

- I. Rikreditohen programet e studimit të Kolegjit Universum për periudhën **tre (3) vjeçare**, (1 tetor 2024 – 30 shtator 2027):
 1. *Gjuhë Angleze me specializim në Gjuhë Gjermane BA 180 ECTS R, me kuotën maksimumi 120 studentë për vit akademik;*
 2. *Shkenca Kompjuterike BSc 180 ECTS, me kuotën maksimumi 250 studentë për vit akademik;*
 3. *Siguri Kibernetike BA Prof. 180 ECTS, me kuotën maksimumi 150 studentë për vit akademik;*
 4. *Shkencë dhe Analizë e të Dhënave MSc 120 ECTS, me kuotën maksimumi 75 studentë për vit akademik;*
- II. Numri i studentëve si në paragrafin I zbatohet për secilin vit të studimit për periudhën e akreditimit.
- III. Obligohet Kolegji Universum që deri më datë 15.11.2024 të dorëzoj në Agjencinë e Kosovës për Akreditim (tutje AKA) Planin e Implementimit të Rekomandimeve të dhëna nga ekspertët ndërkombëtar të akreditimit.
- IV. Obligohet Kolegji Universum të raportoj dhe arsyetoj çdo ndryshim në listën e bartësve të programeve të studimit në AKA, brenda 90 ditëve. Ndryshimet e bartësve bëhen me vendim nga KSHC.
- V. AKA rezervon të drejtën e aplikimit të dispozitave të nenit 21 të Udhëzimit Administrativ Nr.15/2018 për Akreditimin e Institucioneve të Arsimit të Lartë në Republikën e Kosovës, kurdo që vlerëson të arsyeshme dhe të nevojshme.
- VI. Institucioni i Arsimit të Lartë si në paragrafin I mban përgjegjësi ligjore për çdo moszbatim apo tejkalim të këtij vendimi.
- VII. Ky vendim hyn në fuqi me nënshkrimin e tij.

ARSYETIM

Kolegji Universum brenda afatit ligjor ka parashtruar kërkesë në Agjenciën e Kosovës për Akreditim, për ri/akreditimin e programeve të studimit me bartësit e programeve si në tabelë:

Nr.	Programi i studimit	Bartësit e programit
1.	<i>Gjuhë Angleze me specializim në Gjuhë Gjermane BA 180 ECTS R,</i>	Artan Limani Arsim Rexhepi Mihrije Maloku Morina Vjollca Jonuzi
2.	<i>Shkenca Kompjuterike BSc 180 ECTS R;</i>	Ramadan Dervishi Arianit Krypa Nysret Demaku
3.	<i>Siguri Kibernetike BA Prof. 180 ECTS R;</i>	Rrezart Prebreza Besart Prebreza Uran Rraci Besiana Zeka
4.	<i>Shkencë dhe Analizë e të Dhënave MSc 120 ECTS R.</i>	Lavdim Halilaj Armend Salihu Elda Cina

Me qëllim të vlerësimit të programeve të studimit, AKA ka organizuar vizitat me ekspertë ndërkombëtarë të akreditimit në Kolegjin Universum.

Bazuar në nenin 17 të UA Nr.15/2018 për akreditimin e IAL-ve, ekipi i vlerësuesve të jashtëm (Ekspertët ndërkombëtar) ka hartuar raportet e vlerësimit për secilin program, dhe për fushat e standardeve të akreditimit të parapara në Manualin e Akreditimit ka dhënë konstatimet si në vijim:

- Për programin e studimit; *Gjuhë Angleze me specializim në Gjuhë Gjermane BA 180 ECTS R,*** vizita me ekspertët ndërkombëtar të akreditimit me këtë përbërje: Anca Greere, Georg Schuppener dhe Asnate Upmace është organizuar më 27.03.2024, ku nga shtatë fushat e standardeve të akreditimit, ky program është vlerësuar se i përmbush: Plotësisht një (1), Substancialisht tre (3) dhe Pjesërisht tre (3) fusha të standardeve.
- Për programin e studimit; *Shkenca Kompjuterike BSc 180 ECTS,*** vizita me ekspertët ndërkombëtar të akreditimit me këtë përbërje: Anastasios Dagiuklas, Seifedine Kadry, Peeter Normak dhe Damian Michalik është organizuar më 27.03.2024, ku nga shtatë fushat e standardeve të akreditimit, ky program është vlerësuar se i përmbush: Plotësisht një (1), Substancialisht pesë (5) dhe Pjesërisht një (1) fushë të standardeve.
- Për programin e studimit; *Siguri Kibernetike BA Prof. 180 ECTS,*** vizita me ekspertët ndërkombëtar të akreditimit me këtë përbërje: Anastasios Dagiuklas, Seifedine Kadry, Peeter Normak dhe Damian Michalik, është organizuar më 27.03.2024, ku nga shtatë fushat e standardeve të akreditimit, ky program është vlerësuar se i përmbush: Plotësisht një (1) dhe Substancialisht gjashtë (6) fusha të standardeve.

4. **Për programin e studimit; Shkencë dhe Analizë e të Dhënave MSc 120 ECTS**, vizita me ekspertët ndërkombëtar të akreditimit me këtë përbërje: Anastasios Dagiuklas, Seifedine Kadry, Peeter Normak dhe Damian Michalik, është organizuar më 27.03.2024, ku nga shtatë fushat e standardeve të akreditimit, ky program është vlerësuar se i përmbush: Plotësisht një (1), Substancialisht pesë (5) dhe Pjesërisht një (1) fushë të standardeve.

Këshilli Shtetëror i Cilësisë, në mbledhjen e 123-të, të mbajtur më datë 27.03.2024, ka shqyrtuar dokumentacionin e Kolegjit Universum, dhe duke u bazuar në raportet e ekspertëve ndërkombëtarë të akreditimit gjatë realizimit të vizitave, si dhe në rekomandimet përfundimtare të dhëna në raportet finale të vlerësimit nga ekspertët e cekur më sipër, vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

Këshillë juridike: Kundër këtij vendimi pala e pakënaqur mund të paraqet ankesë në Komisionin e ankesave, në afatin prej tridhjetë (30) ditësh nga dita kur pala është njoftuar për aktin administrativ. Ankesa adresohet përmes organit publik që ka nxjerrë aktin.

Vendimi i dërgohet:

- Kolegjin Universum;
- MASHTI;
- Arkivit të AKA-së.

Prof. Asoc. Dr. Hasnija Ilazi

Kryetare e Këshillit Shtetëror të Cilësisë